



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 177 Prot.

Tiranë, më 28/10/2021

V E N D I M

Nr. 41 datë 28.10.2021

**PËR FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E ANËTARËVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR” NË NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,
TIRANË**

Në zbatim të Nenit 4, 5 6 e në vijim, të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 të Senatit Akademik “Për miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Vendimin nr. 78, datë 13.10.2021 dhe në Urdhrin nr. 120, datë 26.10.2021, të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, KIZ në mbledhjen e datës 28.10.2021:

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme në:
 - 1) Fakultetin e Mjekësisë, UMT
 - 2) Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT
 - 3) Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, UMT
2. Të miratojë periudhën e zhvillimit të procesit zgjedhor nga data 27.10.2021 deri në 24.11.2021 dhe datën 24.11.2021, datën e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme sipas pikës 1.
3. Komisionet e Zgjedhjeve të Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë Dentare dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, UMT, të nisin procedurën e pranimit të aplikimeve të kandidatëve për anëtarë të Komisioneve të Përhershme nga data **01.11.2021**

Adresa: Rruga “Dibrës” Nr. 371, 1005 - Tiranë

deri në datë 05.11.2021 dhe të shpallin listën përfundimtare të aplikantëve sipas përcaktimeve të Rregullores të Zgjedhjeve në UMT.

4. Formularët e aplikimit të dorëzohen pranë KZF së përkatëse, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi, si dhe në zbatim të Urdhrit të Rektorit të UMT-së nr. 119, datë 26.10.2021, *“Për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtar të Komisionit të Përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”*
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në mjediset e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT, një kopje e tij i dërgohet KZF-ve të Fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë dhe drejtuesve të njësive kryesore të UMT.

KRYETAR
SILVANA BALA

